

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROJEKTET QË DUHET T'I NËNSHTROHEN Oponencës Teknike, si dhe procedurat që ndiqen

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi "Për miratimin e rregullave për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike, si dhe procedurat që ndiqen" është hartuar me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi i rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike, si dhe procedurat që ndiqen, për të vlerësuar përputhshmërinë e hartimit të projektit me normat, rregullat e projektimit dhe akteve ligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

Objektivat që kërkohen të arrihen nëpërmjet këtij akti është rritja e cilësisë së projektimit të objekteve ndërtimore, e cila do të reflektojë në ndërtimin/(zbatimin) e tyre, në respektim të plotësisimit të kushteve bazë të: i) rezistencës dhe qëndrueshmërisë mekanike; ii) sigurisë nga zjarri; iii) higjienën, shëndetin dhe mjedisin; iv) sigurisë në përdorim; v) mbrojtjes nga zhurmat dhe vi) kursimit të energjisë dhe ruajtjes së ngrohtësisë, të cilat ndikojnë në rritjen e sigurisë, efikasitetit dhe jetëgjatësisë së objekteve të ndërtimit, si dhe duke ndikuar në uljen e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe operimit në kohë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në planin analitik të projektakteve që do të përgatiten dhe paraqiten për miratim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Futja në zbatim e rregulloreve për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike, si dhe procedurat që ndiqen dhe çdo çështje tjetër që lidhet me kryerjen e oponencës do të sjellë një kontroll më efikas, profesional dhe të përgjegjshëm në realizimin e oponencës për një vlerësimin të hartimit të projektit, si dhe një rritje të përgjegjshmërisë profesionale të

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

inxhinierëve në realizimin e projektimit të objekteve ndërtimore me cilësi sipas standardeve dhe kushteve teknike në fuqi,

Përfitimet që rrjedhin nga përcaktimi i këtyre rregullave, do të jenë:

- Rritja e përgjegjësisë profesionale gjatë përgatitjes së studimeve dhe /ose projekteve sipas standardeve teknike të kërkuara në fuqi dhe pa të meta.
- Rritja e përgjegjësisë në kryerjen e projektzbatimit, si dhe në ushtrimin e detyrës me kujdes pa paraqitur rrezik për shëndetin dhe sigurinë publike, si dhe mjedisin.
- Rritja e përgjegjshmërisë në kryerjen e kontrollit të projekteve në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit, me rregullat teknike, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet europiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë;
- Vlerësimi nga oponenti i gjendjes teknike dhe kapacitetet e objektit të projektuar me plotësimin e kërkesave për:
 1. Qëndrueshmërinë mekanike dhe rezistencën.
 2. Sigurinë nga zjarri.
 3. Kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.
 4. Mbrojtjes nga zhurmat dhe vibracionet.
 5. Sigurinë dhe përshtatshmërinë në përdorim.
 6. Sigurimin e jetës dhe shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe mjedisit.
 7. Qëndrueshmërinë e objekteve fqinje dhe infrastrukturës publike.
 8. Siguria e higjenës sanitare.
 9. Aksesueshmërinë.
- Rritja e sigurisë në përdorim;
- Uljen e kostove të tepërta për mirëmbajtjen dhe administrimin;
- Rritja e jetëgjatësisë së veprës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi bazohet në përcaktimin e pikës 2 të nenit 6, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. i cili përcakton se: *"Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponentit teknik sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."*

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon të përafrojë *acquis communautaire*.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi "Për miratimin e rregullave për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike, si dhe procedurat që ndiqen" përbëhet nga pesë krerë:

Në kreun I të tij përcaktohen rregulla të përgjithshme. Ky kre është konceptuar në 4 nene.

Në nenin e parë përcakton se projektet e zbatimit që do t'i nënshtrohen oponencës teknike janë në varësi të llojit të objektit dhe punimeve ndërtimore, të cilat janë përcaktuar në nenin 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. Konkretisht do t'i nënshtrohen oponencës teknike të gjitha ndërtimet publike dhe të gjitha objektet me akses publik, ndërsa për objektet jo publike i nënshtrohen oponencës ato ndërtime me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milion) lekë.

Neni i dytë përcakton që oponenca do të konsistojë në kontrollin e përputhshmërisë së projekt zbatimit me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit, me rregullat teknike, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet europiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin e tretë janë dhënë projektet të objekteve sipas llojit dhe shërbimit të qëllimit dhe destinacionit për të cilin është projektuar, të cilët do t'i nënshtrohen oponencës.

Në nenin e katërt janë përcaktuar kërkesat themelore në plotësim të normave, rregullave ndërtimore dhe akteve ligjore në fuqi për të cilat duhet të kontrollohen projektet e hartuar për një ndërtim të ri, rikonstruksion, mirëmbajtje ose prishje dhe konkretisht për qëndrueshmërinë mekanike dhe rezistencën, sigurinë nga zjarri, kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë, mbrojtjen nga zhurmat dhe vibracionet, sigurinë dhe përshtatshmërinë në përdorim, sigurimin e jetës dhe shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe mjedisit, qëndrueshmërinë e objekteve fqinje dhe infrastrukturës publike, sigurinë e higjenes sanitare dhe aksesueshmërinë.

Në kreun II-të përcaktohet se ku do të konsistojë kontrolli i projekteve, për çfarë do të kontrollohen çdo pjesë e projektit në plotësim të kërkesave themelor. Ky kre është i konceptuar në 11 nene.

Në nenin e pestë është përcaktuar se ku duhet të konsistojë kontrolli i projektit në tërësinë e tij. Konkretisht kontrolli i projektit do të konsistojë në dy drejtime në atë të kontrollit të dokumentacionit ligjor dhe në atë të kontrollit të dokumentacionit teknik. Kontrolli i dokumentacionit ligjor është përcaktuar të konsistojë në licencat përkatëse, si dhe dëshmitë e kualifikimet e duhura për grupin e projektimit, si dhe në policën e sigurimit.

Ndërsa kontrolli i dokumentacionit teknik është përcaktuar që të konsistojë në përshkrimin teknik të punimeve të ndërtimit, përmasimin dhe preventivin. në planimetritë e të gjitha kateve, prerjet tërthore dhe gjatësore, fasadat në të katër anët e objektit, ku është përcaktuar që të jepen në shkallën 1:50, dhe të kenë të shënuar kuotat vertikale relative dhe absolute të katit përdhe dhe kateve/niveleve të tjera; në detajet e nevojshme, të cilat janë përcaktuar të

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

jepen në shkallën 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specififikimet e elementëve me përshkrimin e materialeve, në shkallën 1:50; në projektin konstruktiv; në relacionin gjeomekanik të truallit; në projektin e instalimeve hidroteknike; në projektin e instalimeve elektrike; në projektin e instalimeve të telekomunikacionit dhe sinjalizimit; në projektin i instalimeve të paisjeve/makinerive; në projektin e linjës teknologjike; në projektin e qarkullimit dhe parkimit të automjeteve dhe sinjalizimeve; në projektin e sistemimit të jashtëm, të instalimeve jashtë objektit dhe lidhja me rrjetin e kryesor të instalimeve, arkitekturën e peisazhit dhe hortikulturën; në projektin e punimeve përgatitore/paraprake si gërmimi, punimet për përforsimin e tokës, sigurimi i gropës nën kuotën e sistemuar; në planin e organizimit të kantierit; në planin e sigurisë në kantier; në planin e ndërtimit për masat e mara për akustikën, termikën, masat për efizienzë të energjisë; në planin e mbrojtjes nga zjarri; në kërkesat përkatëse për veprat ujore dhe veprat që kanë lidhje me rrjedhat ujore; në kërkesat përkatëse për aftësitë shkarkuese të veprave ujore; në planin e masave në rastet e prishjeve të mundëshme.

Në nenin e gjashtë është përcaktuar që projekti i çdo vepre ndërtimore të kontrollohet nëse e plotëson kriterin e qëndrueshmërisë mekanike dhe rezistencës.

Në pikën 1 të këtij neni është përcaktuar që për plotësimin e kriterit të qëndrueshmërisë mekanike dhe rezistencës të kontrollohet në mënyrë të pavarur si i marë në tërësi por njëkohësisht edhe për pjesët përbërëse të tij, për gjithë periudhën e specifikuar për jetëgjatësinë shërbyese, duke përballuar të gjitha veprimet mbi objekt të marra parasysh në procesin e projektimit që parashikohen në kushte teknike të projektimit dhe veprime të tjera që burojnë nga rrethanat e posaçme ku mund të gjendet objekti gjatë shërbimit të saj, përfshirë marrjen parasysh të ndërveprimit të strukturës me mjedisin rrethues apo mos cënimin e qëndrueshmërisë së veprave dhe mjediseve fqinje.

Në pikën 2 të këtij neni është përcaktuar që oponenta e projektit strukturor duhet të kryhet e plotë dhe të tregojë verifikimet strukturore në mënyrë të pavarur nga llogaritjet e kryera për qëllimin e projektit.

Duke parë rëndësinë që ka pjesë e qëndrueshmërisë dhe rezistencës së objektit nga veprimet që mund të ndodhin mbi strukturë si ato natyrore dhe jo vetëm, në pikën 3 të këtij neni është përcaktuar që oponenta e projektit strukturor duhet të kryhet në dy faza. Faza e parë oponentës kryhet ndaj projektit strukturor për miratimin e lejes së ndërtimit të veprës dhe faza e dytë kryhet për projektin e zbatimit pjesa strukturore. Gjetjet dhe udhëzimet e oponentës në të dyja fazat është përcaktuar që të reflektohen në projektin strukturor. Por është lënë opsioni nëse gjetjet dhe udhëzimet e oponentës kundërshtohen me vërtetime dhe argumentime përkatëse nga projektuesi, të citat pranohen dhe nga oponenti, ato shprehen në oponentën përfundimtare.

Në pikën 4 të këtij neni, për rëndësinë që ka pjesa strukturore për qëndrueshmërinë e objektit, është përcaktuar që leja e ndërtimit zbardhet nëse oponenta është shprehur pa vërejtje dhe/ose udhëzime dhe ka të cilësuar që projekti është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit, rregullave dhe normave në fuqi.

Në pikën 5 të këtij neni është përcaktuar që nëse gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit kërkohen të kryhen ndryshime në projektin strukturor të zbatimit, ndryshimet e propozuara të

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

cilat duhet të jenë hartuar nga projektuesi dhe të shoqëruara me raportin përkatës vërtetues strukturor, përveç miratimit të mbikqyrësit përpara se autoriteti përgjegjës i planifikimit të territorit të miratojë ndryshimin duhet të merret mendimi dhe dakortësia e oponentit.

Në pikën 6 të këtij neni është përcaktuar që kontrolli i projektit strukturor të kontrollohet për specifikimet teknike, udhëzimet teknike dhe vizatimet të cilat të jenë në përputhshmëri me normat dhe rregullat e projektimit në fuqi; rrethanat projektuese për sigurinë strukturore; konceptin dhe veçantitë e skemës strukturore, përfshirë rregullsinë e saj; vizatimet e përgjithshme dhe hollësitë inxhinierike duke përfshirë dhe mos u kufizuar vetëm në themelet, planet e strukturave me elementet e tyre përbërës, nënçatitë etj.; për secilën të ketë të paraqitur së paku dy prerje karakteristike në lartësi me pozicionim të elementeve në shkallë 1:100 ose 1:50, si dhe pjesë të veçanta (detaje) në shkallë 1:25. Në rastet e ndërtimeve të cilat zhvillohen pjesërisht ose plotësisht nëntokë, në vizatimet e projektit është përcaktuar se duhet të jepen edhe vizatimet dhe hollësitë përkatëse inxhinierike si për veprat apo masat mbrojtëse të veprës që ndërtohet ashtu edhe për veprat fqinje të cilat ndikohen nga ndërhyrja e parashikuar; analizat strukturore statike dhe dinamike (në veçanti veprimi sizmik dhe i erës dhe çfarëdo veprimi tjetër që nevojitet në vendin ku ndërtohet vepra) pavarësisht materialit/eve parësor strukturor me të cilin është konceptuar struktura dhe mënyrës së ndërtimit (e derdhur në vend apo parafabrikuar). Këto analiza kryhen si për gjendjet e fundit kufitare ashtu edhe për gjendjet kufitare të shërbyeshmërisë (përdorimit). Në rastet kur vepra zhvillohet pjesërisht apo tërësisht nëntokë apo kur janë të nevojshme gërmime për vendosjen e saj, analiza gjeoteknike dhe strukturore është e domosdoshme si për veprat mbrojtëse të shpateve ashtu edhe për ndërveprimin e strukturës me mjedisin ndërveprues; vendndodhjen; natyra dhe intensiteti i ngarkesave dhe veprimeve, përshkrimet dhe kombinimet tyre në harmoni me kushtet teknike të projektimit në fuqi, faktorët pjesor të sigurisë dhe të kombinimit në përputhje me rrethanat projektuese, gjendjet kufitare të projektimit dhe llojin e veprës; llogaritjet e ekuilibrit të përgjithshëm, kontrollet në përmbysje, rrëshqitje, mosshëmbje duke përfshirë llogaritjet në qëndrueshmëri, zhvendosjet tërësore dhe relative, dukurinë P- Δ përfshirë epjen e pjesshme apo verifikime të tjera me natyrë jolineare që mund të çojnë strukturën e veprës në gjendje plastike në marrëdhëniet sforcim-deformim; përmasat e fugave sizmike apo fugave termike (bymim-tkurrje) si dhe tolerancave të nevojshme për rastet kur vepra mbështetet në mjedise që shkaktohen çedime të ndryshme, etj.; kërkesat për duktilitet tërësor, duktilitet të pjesshëm dhe për duktilitet të elementeve parësor sizmik rezistues; Të gjitha elementët parësor strukturor, pavarësisht materialit të tyre përbërës, si dhe ndikimi në sjelljen dhe sigurinë tërësore strukturore në rastet kur me norma teknike kërkohet marrja e masave për sigurinë ndaj zjarrit; hollësire inxhinierike (prerjet, nyjat, bashkimet, fugat, bashkimet me bulona apo saldim, etj.) - të punuara dhe paraqitura në atë mënyrë që të plotësojnë kriteret e rregullave teknike për projektim, të lexueshme dhe të kuptueshme për zbatim në shkallën 1:5; 1:10; 1:20; 1:25; 1:50 në varësi të shkallës së vështirësisë dhe shkallës së ngatërrimit së strukturës – është përcaktuar që duhet të jepen në mënyrë numerike në përputhje me normat në fuqi; të gjitha strukturat të cilat zhvillohen me 2 (dy) apo më shumë kate nën tokë si dhe nëse gropa ndërtimore është e riskuar nga shembja edhe kur ka më pakë së (2) dy kate duhet që të kontrollohet projekti për sigurinë e gropës ndërtimore,

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

shpateve të saj dhe objekteve në afërsi. Gjithashtu është përcaktuar që kontrolli duhet të bëhet sipas kërkesave që jep SSHEN përkatëse; të gjitha llogaritjet e kryera dhe dokumentet e hartuara për qëllimin e projektimit të veprës të cilat duhet të jenë në përputhje me kushtet teknike të projektimit në fuqi, kushtet teknike të ndërtimit si dhe standardet SSHEN.

Në nenin e shtatë është përcaktuar që projekti i instalimeve të makinerive të kontrollohet për informacionin që përmbajnë specifikimet teknike të materialeve, pajisjeve, paramasës me udhëzimet teknike për ekzekutimin e punëve ndërtimore për makineritë; përshkrimin teknik, kushtet teknike të instalimeve të ngrohjes/ventilimit dhe ashensorit/ eskalatorit, testimet dhe specifikimet e standardeve të aplikuara në projekt; raportin e izolimit termik, përfshirë specifikimet e materialeve për katet nën tokë, muret e jashtme, dyert, dritaret dhe mbulesën, koeficienti i kalimit të nxehtësisë; llogaritjet e efikasitetit të energjisë për ventilim, ngrohje dhe ftohje, llogaritjet termike; pajisjet dhe tubat për qarkullimin e ajrit, kanalet për ventilim, dimensionimi i sistemeve të ventilimit; paraqitjet e oxhakut për shkarkimin e gazrave të djegies, dimensionimi i oxhakut; paraqitjet e sistemit të rrjetit për ngrohje/ftohje, kalkulimet e rrjetit; llogaritjet dhe dimensionimi i sistemit të ventilimit dhe prezentimi grafik. Ventilimi i objekti, ventilimi i garazhave, nyjeve sanitare, kuzhinave, dhe të gjithë ambjenteteve që nevojiten për ventilim; paisjet të paraqitura në dhomën teknike si kaldajat, nënstacioni termik, si dhe dimensionimi i paisjeve; paisjet e ftohjes të paraqitura, dimensionimi i paimëve ftohëse si makinat ftohëse, pompat termike, dhe të gjithë makineritë e tjera ftohëse; paraqitjet e magazinimit të materialeve të djegshme, depozitim i lëndës djegëse; paraqitjet e paisjeve të sistemit diellor, dimensionimi i paisjeve; paraqitjet për ashensorët/shkallët lëvizëse dhe çdo gjë tjetër e ngjashme me to dhe konkretisht për projektin për ashensorë/shkallë lëvizëse, llogaritjet dhe pjesa grafike, paramasimi, udhëzimet teknike për zbatimin dhe mirëmbajtja e punëve të ndërtimit, paraqitjet e vizatimeve të elementeve të ndërtimit si: i) pjesët grafike të projektit të makinerive, linjat teknologjike, ii) planimetritë dhe detajet e nevojshme të projektit të makinerive, iii) skemën funksionale të instalimeve termoteknike, ventilimit dhe klimatizimit të pjesës grafike të projektit të makinerive, iv) detajet për zbatim të cilat jepen në shkallën 1:5, 1:10 dhe 1:20 në varësi nga kompleksiteti i tyre; planimetrinë e instalimeve, bazat e objektit, në shkallën 1:50 e dimensionuar, kuotat e lartësisë, ku tregohet qartë pozicioni, drejtimi dhe hapësira e instalimeve të makinerive.

Në nenin e tetë është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit të instalimeve elektrike dhe konkretisht në përshkrimin teknik, kushtet teknike për instalimet elektrike të rrymave të forta dhe rrymave të dobëta, instalimi i rrufepritësit, kushtet për testim; llogaritjet e seksionit të përçuesit sipas rrymës së ngarkesës së lejuar; llogaritjet e rënies së tensionit; llogaritjet e rezistencës së shpërndarjes të tokëzuesit në themel dhe tokëzuesit mbrojtës; paramasimin dhe parallogaritjen duke përfshirë udhëzimet teknike për zbatimin e punimeve të ndërtimit; bazat e kateve karakteristike dhe mbulesës, bazat e reflektuara të tavanit, pamjet dhe prerjet në shkallën 1:100 ose 1:50 të dimensionuara dhe të kuotuar ku tregohet qartë pozicioni, madhësia, drejtimi dhe hapësira e instalimeve elektrike, nëse janë paraqitur: pikat e lidhjes në rrjetin ekzistues publik të furnizimit; rregullimi i tokëzimit dhe lidhjes; matësit elektrik dhe tabelat e shpërndarjes; planin e brendshëm dhe të jashtëm për shpërndarjen dhe pikat lidhëse për pajisje, transformatorë, ndërpresë, priza, trupa

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

ndriçues, panele kontrolli, televizion, telefon, kabllor, internet, komunikim, sistemet e ndriçimit emergjent, instalimet mekanike dhe punime të tjera elektrike; skemat e instalimit të rrufepritësit; skemat një polare të rrymës së fortë dhe rrymës së dobët; prodhimin alternativ të qëndrueshëm të energjisë; skemat e veprimit të instalimeve elektrike të rrymës së fortë dhe rrymës së dobët; skemat një polare të instalimit të barazimit potencialit kryesor dhe barazimit të potencialit plotësues në nyje sanitare.

Në nenin e nëntë është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit të instalimeve hidroteknike dhe konkretisht në specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve, paramasave me udhëzimet teknike për zbatimin e punëve të ndërtimit, vizatimeve, vizatimeve të detajeve dhe llogaritjet e duhura; përshkrimin teknik, kushtet teknike të instalimeve të ujit dhe kanalizimit, testimet dhe specifikimi i standardeve të aplikuara në projekt; llogaritjet hidraulike të tubave të ujit të pishëm, kanalizimit të ujrave të zeza, drenazhimit dhe mbledhjen e ujrave nga fenomenet atmosferike; planimetrinë e instalimeve ku përfshihen bazat e themelit, kateve dhe mbulesës, paraqitur në shkallën 1:100 ose 1:50 të dimensionuar dhe kuotuar në lartësi ku tregohet qartë pozicioni, madhësia, drejtimi dhe hapësira e instalimeve hidroteknike; paramasat dhe parallogaritja, përfshirë udhëzimet teknike për zbatim të punëve të ndërtimit; projektin e instalimeve hidroteknike të jashtme, përfshirë pikat e lidhjes së ujit, valvulat ndarëse për rrjetin publik të furnizimit, matësit e ujit, impiantet kundër zjarrit, projektin për shkarkimin e ujërave të zeza, pusetat, vendet e pastrimit, diametri, gjatësia dhe pjerrësia e tubave, dhe të gjithë elementët e tjerë të domosdoshëm; projektin e instalimeve hidrosanitare të brendshme përfshirë, projektin e furnizimit dhe shpërndarjes së ujit të ngrohtë dhe të ftohtë, tubacionet e kanalizimeve sanitare, tubacionet e ajrosjes, valvulat, edhe çdo element tjetër i domosdoshëm në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; saktësia e llogaritjeve dhe efikasiteti i energjisë për instalimet hidrosanitare në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; pikat e lidhjes së ujit dhe valvulat ndarëse për rrjetin publik të furnizimit, matësit e ujit, projektin për shkarkimin e ujërave të zeza, pusetat, vendet e pastrimit, madhësia e tubacioneve, dhe çdo element tjetër i domosdoshëm në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; ngrohësit e ujit, projektin e furnizimit dhe shpërndarjes së ujit të ngrohtë dhe të ftohtë dhe drenazhet sanitare, ndërprerësit dhe ndarësit dhe çdo element tjetër i domosdoshëm në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; izolimet e instalimeve hidrosanitare, në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; ventilatorët e ajrit në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; nyjet e tërthorta të veçanta të mbeturinave dhe lidhjet në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; kullimet e ujërave atmosferike në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; sistemin e jashtëm të ujitjes për bujqësi dhe pëlsazhi, vizatimet e detajuara të elementeve të ndërtimit për instalimet hidroteknike.

Në nenin e dhjetë është përcaktuar se për cilat objekte është i detyrueshëm kontrolli i projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe konkretisht për objektet ndërtimore publike dhe biznesit; objektet ndërtimore me funksion banimi; objektet ndërtimore industriale; objektet energjitike dhe objektet hidroteknike.

Gjithashtu është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe konkretisht në plotësimin e kushteve të projektimit dhe

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

standarteve në fuqi, të cilat sigurojnë parandalimin e ndezjes dhe të përhapjes së zjarrit dhe tymit, ndërsa për rastet e zjarrit në sigurimin e qëndrueshmërisë së objektit të ndërtimit ose pjesëve përbërëse të tij për një periudhë kohe të përcaktuar në kushtet dhe standardet në fuqi, parandalimin brenda objektit të ndërtimit nëpërmjet përdorimit të sistemeve efektive të fikjes dhe të bllokimit të përhapjes së zjarrit dhe tymit; ndalimit të përhapjes së zjarrit në objektet e ndërtimit fqinjë, hyrjet dhe përdorimet e mjeteve dhe automjeteve për fikjen dhe mbrojtjen nga zjarri; evakuimet e njerëzve, kafshëve nëpërmjet daljeve të emergjencës dhe fikja efektive e zjarrit; përdorimin e produkteve të ndërtimit dhe instalimeve në punimet e ndërtimit të cilat duhet të garantojnë rezistencën ndaj zjarrit dhe formimit të tymit; pajisjen me sisteme të përhershme mbrojtëse ndaj rrufeve për objektet e ndërtimit të cilat për shkak të vendndodhjes, llojit të ndërtimit ose përdorimit janë të ndjeshme; kontrolli i projektit për mbrojtjen nga zjarri do të konsistojë për informacionin që përmbajnë specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve, paramasat dhe udhëzimet teknike për zbatimin e punimeve të ndërtimit, vizatimeve, të detajeve; Dhomat e brendshme rezistente ndaj zjarrit, mjetet horizontale dhe vertikale të evakuimit, përfshirë elementet e brendshme të ndërtimit rezistente ndaj zjarrit siç janë konstruksioni, muret, dyert, dritaret, lobit, shkallët, ashensorët, boshtet e shërbimit në ndërtesë dhe dyert për qasje në to, instalimet mekanike për ngrohje dhe/ose ftohje, barrierat e fshehta të hapësirave, dhe çdo detaj tjetër i domosdoshëm në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; kokat e detektorëve të zjarrit dhe/ose tymit, kutitë për thirrje alarmi, panelet e kontrollit të detektorëve dhe alarmit, transmetuesit e zërit të alarmit, shenjat për siguri nga zjarri, ndriçimi emergjent, aparatet për fikjen e zjarrit dhe pajisjet e tjera për fikjen e zjarrit, kanalet e ventilimit dhe boshtet për katet nëntokësore dhe çdo element tjetër i domosdoshëm në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; sistemet e spërkatjes, valvulat e kontrollit të tyre dhe pajisjet dhe çdo element tjetër i domosdoshëm në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; oxhaqet dhe ventilatorët në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; sistemi të kontrollit të tymit, modeli i operimit dhe pajisjet e kontrollit, në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; qasjet dhe rrugët horizontale dhe vertikale, vendndodhja e vijës kryesore të furnizimit me ujë, kanalet vertikale për instalimet hidrosanitare dhe kanalet vertikale për instalimet e tjera, hidrantët për zjarrfikësit, objektet e jashtme ose të brendshme për shërbimet e zjarrfikjes dhe shpëtimin në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; hapësirat e hapura dhe të mbyllura me rrezik të lartë në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; masat mbrojtëse për magazinimin e materialeve të djegshme në përputhje me standardet dhe normat në fuqi; vizatimet e detajuara të elementeve të ndërtimit për mbrojtjen nga zjarri në përputhje me standardet dhe normat në fuqi për mbrojtjen nga zjarri.

Në nenin e njëmbëdhjetë është përcaktuar se për cilat objekte është i detyrueshëm kontrolli i projektit për mbrojtjen nga zhurmat dhe konkretisht për ndërtesat, infrastrukturën rrugore, hekurudhat dhe aeroportet. Gjithashtu është përcaktuar që çdo projekt ndërtimor duhet të kontrollohet për të plotësuar kriterin që zhurmat dhe vibracionet e perceptuara nga përdoruesit të mbahen të ulëta deri në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi, për të mos dëmtuar shëndetin dhe cilësinë e jetës, si dhe për të lejuar të kryhet aktiviteti jetësor dhe/ose të punohet në kushte optimale, si dhe vibrimet e krijuara brenda dhe jashtë objektit të

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

ndërtimit të amortizohen në mënyrë efektive për të parandaluar ndonjë rrezik ose shqetësim të paarsyeshëm tek njerëzit dhe kafshët.

Gjithashtu është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit të mbrojtjes ndaj zhurmave dhe konkretisht në informacionin që jepet në specifikimet teknike për materialet dhe pajisjet, dimensionet, vizatimet dhe të detajeve sipas kushteve dhe standardeve teknike në fuqi, të cilat të jenë dhënë të qarta për zbatimin e punimeve të ndërtimit; mbulesën, muret, dyert, dritaret e jashtme; pllakat, muret, dyert, dritaret e brendshme; instalimet mekanike; instalimet hidrosanitare; shkallët, ashensorët, lobit, kanalet e mbeturinave, dhe elementë të tjerë pjesë e objektit që do t'i nënshtrohet kontrollit të projektit; vizatimet e detajuara të elementeve të ndërtimit.

Në nenin e dymbëdhjetë është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit në respektimin e rregullave të aksesueshmërisë në fuqi dhe konkretisht në informacionin që përmbajnë specifikimet teknike të materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve me udhëzimet teknike për zbatimin e punëve të ndërtimit, vizatimeve, vizatimet e detajeve; sipërfaqet me ndryshime në lartësi, siç janë rampat, shkallët dhe parrakët e tyre, ashensorët dhe platformat e ngritjes; hyrjet, lobit, hapësirat e qarkullimit, banjot, kuzhinat, dhomat, klasat e mësimi, hapësirat e punës, banesat, baret dhe restorantet, dhomat e zhveshjes, dushet, pishinat, vendi për qëndrim të spektatorëve, telefonat publikë dhe tekstofonët, fakset, makinat ATM, telefonat publik, pajisjet elektrike të kontrollit, dorëzat e dyerve dhe dritareve, sportelet e shërbimit dhe tavolinat, tabelat e njoftimit, tabelat e udhëzimeve dhe shenjat, si dhe element të tjerë pjesë e objektit që do t'i nënshtrohet kontrollit të projektit; vizatimet e detajuara të elementeve ndërtimor në se janë në harmoni me rregullat teknike në fuqi për aksesueshmërinë.

Në nenin e trembëdhjetë është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit në përmbushjen e rregullave dhe standardeve për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë dhe në se janë marrë parasysh kushtet lokale dhe klimaterike të vendit, kushtet e komfortit të brendshëm të ndërtesave, si dhe kostot efektive, duke përmbushur përcaktimet e dhëna në ligjin nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave". Gjithashtu është përcaktuar që në relacionin shoqërues të certifikatës së përkohshme të performancës së energjisë, të projekt zbatimit duhet të ketë të përshkruar plotësimin e këtyre kushteve, si dhe ky relacion duhet të jetë pjesë e dokumentacionit që shoqëron projektin në fazën e kryerjes së oponencës.

Në nenin e katërbëdhjetë është përcaktuar se ku duhet të konsistojë domosdoshmërisht kontrolli i projektit në përmbushjen e rregullave teknike, standardeve dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e higjenës, shëndetit dhe mjedisit. Gjithashtu është përcaktuar që projekti duhet të kontrollohet në se është projektuar në mënyrë të tillë që të mos përbëjë problem për higjenën ose shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, të cilët kryejnë aktivitetet në të ose përreth saj, si dhe nëse është dhënë ventilimi efektiv, nga lagështia, çlirimi i gazeve të rrezikshme, lëshimi i grimcave në ajër, krijimi i tymrave dhe aromave të padëshirueshme, mbrojtja nga emëtimi i valëve elektromagnetike në nivele të dëmshme, nga rrezatimet përfshirë atë radioaktiv, ndotja ose helmimi i ujit apo tokës dhe nga mbeturinat e lëngshme apo të ngurta përfshirë edhe ujrat e zeza.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

Në nenin e pesëmbëdhjetë është përcaktuar se projekti i cili hynë në procesin e kontrollit duhet të jetë i firmosur nga projektuesit sipas kategorive të liçencimit, si dhe të jetë konfirmuar nga autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për lejen e ndërtimit.

Në kreun III të tij përcaktohen procedurat që duhet të ndiqen për kryerjen e oponencës teknike. Ky kre është konceptuar në 9 nene.

Në nenin e gjashtëmbëdhjetë janë përcaktuar institucionet që do të kryejnë oponencën teknike për projektet e zbatimit të objekteve publike dhe jo publike dhe konkretisht Instituti i Ndërtimit si institucioni që ka në përshkrimin e punës së tij kryerjen e oponencës si institucion i specializuar për projektim dhe akt ekspertimi, si dhe Universiteti Politeknik i Tiranës i cili me fakultetet e tij mbulon të gjitha specialitetet për kontrollin e kërkesave kryesore në projektet e objekteve ndërtimore të të gjitha llojeve, duke patur një trup akademike me inxhinierë të këtyre fushave. Të dy institucionet kanë përvojën në këtë fushë pasi kanë qënë ndërvite të ngarkuar për të kryer këtë shërbim nëpërmjet akteve ligjore.

Gjithashtu në këtë nen është përcaktuar llojin e objekteve për të cilat do të kryhet oponenca teknike për secilin institucion dhe konkretisht Instituti i Ndërtimit do të kryejë oponencën për ndërtime publike dhe objekte me akses publik. Ndërsa Universiteti Politeknik i Tiranës do të kryejë oponencën për ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë. Në këtë ndarje është patur në konsideratë përgjegjësia institucionale e kombinuar dhe me eksperiencën ndër vite.

Në nenin e shtatëmbëdhjetë është përcaktuar që oponenca teknike të kryhet nga punonjës të Institutit të Ndërtimit dhe/apo Universitetit Politeknik të Tiranës të cilët duhet të jenë specialistë të fushës të liçencuar në projektim dhe me një eksperiencë prej 15 vitesh në fushën për të cilën do të ushtrojnë kontrollin. Vitet janë marrë në analogji me vitet për licencim në mbikqyerje.

Gjithashtu është përcaktuar që në se këto institucione, për pjesë të caktuara të projektit që i nënshtrohet kryerjes së oponencës të cilët i përkasin plotësimin të njërit prej kritereve kryesorë, nuk kanë në strukturën e tyre punonjës që të plotësojnë kriterin e mësipërm, është përcaktuar që të lidhin një marrëveshje bashkëpunimi midis tyre për të mbuluar me specialistë që plotësojnë këtë kriter.

Për rastet kur këto institucione nuk kanë në asnjërën nga strukturat e tyre reciproke punonjës që të plotësojnë kriterin e përcaktuara më sipër, është përcaktuar që të marrin profesionistë të lirë të cilët duhet të jenë të paanshëm dhe të mos kenë konflikt interesi me shioqërinë e projektimit apo projektuesin që ka hartuar projektin. Për këtë arsye është parashikuar që në
~~*edo rast kontrolluesit e projektit të lëshojnë deklaratën e konfliktit të interesit.*~~

Në rastet kur Instituti i Ndërtimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës duhet të marrin specialistë të fushës ata përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e profesionistëve por si kritere bazë janë përcaktuar i) diplomimi në fushën për të cilën specialisti duhet të ushtrojë kontrollin; ii) liçencimi me kategoritë përkatëse që i përkasin fushës për të cilën do të ushtrohet kontrolli në plotësimin e kërkesës themelore që duhet të plotësojë projekti; iii) eksperiencia prej 15 vitesh në projektim në fushën në të cilën duhet të ushtrojë kontrollin.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

Në nenin e tetëmbëdhjetë është përcaktuar që kontrolli i projektit të zbatimit të kryhet nga një grup profesionistësh ku secili sipas liçencimit dhe kategorive që disponon do të kryejë dhe do të jenë përgjegjës për konkluzionin përfundimtar në plotësim të kërkesës themelore sipas standardeve dhe rregullave ndërtimore në fuqi.

Gjithashtu në këtë nen është përcaktuar që në se në kryerjen e kontrollit të projektit kontrolluesi vërteton se pjesë të caktuara të projektit nuk mund të kontrollohen nga asnjëri prej anëtarëve të grupit të kontrollit, është i detyruar të lajmëroj drejtuesin e institucionit për të caktuara specialist të fushës për të ushtruar kontrollin për atë pjesë të projektit.

Për kontrollin e projektit, pjesëve të tij të cilat janë llogaritur sipas programeve të çertifikuara, si p.sh. pjesa konstruktive, për të patur rezultate të krahasueshme është përcaktuar që të kontrollohen me të njëjtin program të çertifikuar.

Në këtë nen është parashikuar që grupi i kontrollit në fund të procesit të kontrollit të projektit, për plotësimin e të gjithë kërkesave themelore, harton oponencën ku përshkruan të gjithë gjetjet dhe rekomandimet aty ku është e nevojshme. Në rast të mos plotësimit të njëres prej kërkesave themelore në hartimin e projektit, është përcaktuar që projekti i kthehet kërkuarit me argumentimin dhe rekomandimin përkatës.

Në nenin e nëntëmbëdhjetë janë përcaktuar procedura që duhet të ndiqet për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për kryerjen e oponencës dhe konkretisht:

Në pikën 1 të këtij neni është përcaktuar që porositi i drejton kërkesën për kryerjen e oponencës teknike institucionit të përcaktuar së bashku me dokumentacionin përkatës.

Në pikën 2 është përcaktuar që institucioni që merr kërkesën duhet që brenda 5 ditëve të kontrollojë dokumentacionin e paraqitur për saktësinë sipas llojit të projektit.

Në pikën 3 është përcaktuar që nëse dokumentacioni është i plotë brenda 5 ditëve duhet të ngrihet grupi i kontrollit të projektit që do të hartojë oponencën, i cili është përcaktuar të drejtohet nga një punonjës i caktuar nga eprori i institucionit, njëkohësisht të njoftohet porositi për fillimin e kryerjes së oponencës.

Në pikën 4 të këtij neni është përcaktuar që nëse dokumentacioni nuk është i plotë njoftohet porositi për plotësimin e tij brenda 10 ditëve kalendarike. Në se dokumentacioni nuk është plotësuar në afatin e kërkuar është përcaktuar që dokumentacioni t'i kthehet porositisit.

Në pikën 5 është përcaktuar që grupi i kontrollit të projektit të caktojë një kohë për realizimin e oponencës por jo më shumë se 60 ditë kalendarike. Në përcaktimin e këtij afati është patur parasysh që kontrolluesi i projektit të ketë një kohë të mjaftueshme për kryerjen e plotë të kontrollit, në analogji me kohën e projektimit por jo e plotë me të.

Në nenin e njëzetë është përcaktuar që oponencat e projekteve të zbatimit të kontrolluara të regjistrohen në një regjistër i cili mbahet nga institucioni që kryen oponencën dhe publikohet në faqen e tij zyrtare.

Në nenin e njëzetë e një është përcaktuar se çfarë duhet të përmbajë oponenca që do të bazohet në kontrollin e projekt zbatimit dhe konkretisht i) emrin, mbiemrin dhe titullin profesional të kontrolluesit të projekt zbatimit; ii) titullin e projekt zbatimit dhe emërtimin e objektit në tërësi dhe pjesore për të cilat është kryer kontrolli; iii) emrin, mbiemrin dhe adresën e zhvilluesit; iv) shënimet për personin fizik ose juridik i cili ka hartuar projektin, si edhe emrin e projektuesit; v) liçencën e projektuesit/ve; vi) pjesët e kontrolluara të projekt

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

zbatimit; vii) legjislacionin, rregullat dhe standardet ndërtimore në fuqi në bazë të të cilave është kontrolluar përputhshmëria në hartimin e projektit; viii) shënimin për gjetjet gjatë kontrollit të projektit; ix) arsyetimin i kontrolluesit për harmonizimin e projekt zbatimit me legjislacionin e ndërtimit, rregullat dhe standardet ndërtimore në fuqi, në raport me kërkesat themelore për ndërtimin, të cilat janë kontrolluar në të gjitha pikat të përcaktuara; x) arsyetimin e kontrolluesit për harmonizimin e projekt zbatimit me projektin për marrjen e lejes së ndërtimit; xi) datën dhe numrin e oponencës, nënshkrimin e kontrolluesit/ve si specialistë të autorizuar për kontrollin e projekt zbatimit.

Gjithashtu në këtë nen është përcaktuar që në rast se nga kontrolli konstatohet se projekt zbatimi ka mangësi apo gabime, në oponencë në vend të arsyetimit të kontrolluesit për harmonizimin e projekt zbatimit me legjislacionin e ndërtimit, rregullat dhe standardet ndërtimore në fuqi, në raport me kërkesat themelore për ndërtimin, të cilat janë kontrolluar në të gjitha pikat të përcaktuara, të vendoset shënimi nga kontrolluesi ku shpjgohet mos harmonizimi i projekt zbatimit me legjislacionin e ndërtimit, rregullat dhe standardet ndërtimore në fuqi.

Në nenin e njëzetë e dy është përcaktuar se shfuqizimi i oponencës bëhet në rast se kontrolli i projektit nuk është bërë në përputhje me nenin 17 ose nenin 18 të këtij vendimi dhe në kundërshtim me legjislacionin e ndërtimit, rregullat dhe standardet ndërtimore në fuqi. Në këtë rast porositi i oponencës, autoriteti i planifikimit që jep lejen e ndërtimit, mund të propozojë shfuqizimin e oponencës dhe ribërjen e saj, pranë institucionit që e ka hartuar duke e vënë në dijeni ministrinë e linjës. Me marrjen e kërkesës për rishikim të oponencës institucioni që kryen oponencën është përcaktuar të ri ngrejë grupin për kryerjen e oponencës duke ju përmbajtur përcaktimeve për përzgjedhjen dhe ngritjen e grupit të oponencës. Gjithashtu është përcaktuar që propozimi për shfuqizimin e oponencës shtyn kohën e dhënies së lejes së ndërtimit.

Në nenin e njëzetë e tre është përcaktuar që institucioni që kryen oponencën është i detyruar të dorëzojë pranë ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, një raport vjetor për oponencat e kryera të një viti më parë, në tre mujorin e parë të vitit aktual.

Në nenin e njëzetë e katërt është përcaktuar që zhvilluesi lidh aktmarrëveshjen me institucionin që do të kryejnë oponencën teknike për projektin e veprës së ndërtimit, para kryerjes së oponencës, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi, ku është përcaktuar edhe vlera e oponencës. Në aneksin 1 është qartësuar procesi i llogaritjes së tarifës së oponencës, që si metodologji llogaritje është e njëjtë me atë që ka qenë dhe me aktet që sot janë në fuqi. Në këtë metodologji është shtuar rritja e vlerës së oponencës me 30% në rastet kur oponenca zhvillohet në dy faza: i) oponencë mbi projektin për marrjen e lejes dhe ii) për projektin e zbatimit para se të zbardhet leja e ndërtimit. Tarifa për fazën e dytë është përcaktuar të llogaritet me normat në përqindje të aplikueshme për fazën e shërbimit të përcaktuara në pikën 2 të aneksit 1 të këtij vendimi, duhet të reduktohen me 50%, kjo është marrë në analogji me përcaktimin në pikën 2 të nenit 11 të KM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim”. Në rastet kur oponenti e gjykon të nevojshme për të kryer inspektimin në terren e cila ndodhet jashtë vendit të banimit të tij është përcaktuar që zhvilluesi detyrohet që

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit”.

të kompensojë shpenzimet e udhëtimit dhe dietën. Gjithashtu është përcaktuar që për raste të ndryshme dhe për objekte të rëndësisë së veçantë, kur oponenti kryhen oponencën dhe të ndryshimeve të projektit gjatë zbatimit të punimeve, tarifat rritet me 20%.

Në kreun IV përcaktohen dokumentacioni teknik që duhet të paraqitet për kryerjen e oponencës teknike. Ky kre është konceptuar në 5 nene.

Në nenin e njëzetë e pestë është përcaktuar dokumentacioni teknik që duhet për kryerjen e oponencës për projektet e objekteve shtetërore që rikonstruktohen paraqiten dhe konkretisht kërkesa e zhvilluesit për kryerjen e oponencës; detyra e projektimit e miratuar nga zhvilluesi (origjinale ose e noterizuar); marrëveshja midis zhvilluesit dhe sipërmarrësit të hartimit të projektit; relacion teknik mbi gjëndjen ekzistuese të objektit shoqëruar me fotot përkatëse; projekti arkitektonik ekzistues; projekt ideja e miratuar nga zhvilluesi; projekti konstruktiv ekzistues, llogaritjet konstruktive analitike për objektin ekzistues; deklaratë noteriale e konstruktorit mbi hartimin e projektit konstruktiv, llogaritjet analitike në formë elektronike; studimi gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit i rifreskuar (noterizuar); studimi inxhiniero-sizmiologjik (noterizuar) për objekte mbi tetë kate ose vërtetim nga Instituti i Sizmiologjisë për objekte nën tetë kate; projekti hidrosanitar i firmosur nga inxhinieri hidroteknik (kanalizime, ventilim, ngrohje, mbrojtje nga zjarri) dhe relacioni përkatës; projekti elektrik i firmosur nga inxhinieri elektrik dhe relacioni përkatës; preventivi i objektit i firmosur nga grupi preventivues dhe zhvilluesi; çertifikata e përkohshme e performancës së energjisë; specifikime teknike. Për rastin kur mungon projekti konstruktiv ekzistues është përcaktuar që kërkesa të shoqërohet me aktekspertizën teknike të gjëndjes ekzistuese të objektit, hartuar nga një grup specialistësh të licencuar sipas fushave përkatëse të miratuar nga zhvilluesi, e cila shoqërohet dhe me fotot e gjëndjes ekzistuese në pjesët e jashtme të objektit (fasadat) dhe pjesët e brendëshme të tij.

Në nenin e njëzetë e gjashtë është përcaktuar që për kryerjen e oponencës për projektet e ndërtesave dorëzohet pranë institucionit që do të jetë përgjegjës për kryerjen e saj dokumentacioni teknik si kërkesën e zhvilluesit për kryerjen e oponencës; detyrën e projektimit e miratuar nga zhvilluesi për objektet që financohen nga buxheti i shtetit (origjinale ose fotokopje e noterizuar); studimi gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit (fotokopje e noterizuar) dhe dokumentacionin topografik të objektit; studimi inxhiniero - sizmiologjik (noterizuar) për objekte mbi tetë kate dhe objektet arsimore dhe shëndetësore, ose vërtetim nga Instituti i Gjeoshkencave për objekte nëntetë kate; projekti arkitektonik i firmosur nga arkitekti shoqëruar me relacioni arkitektonik; projekti konstruktiv i firmosur nga konstruktori, shoqëruar me relacioni teknik i hartuar dhe firmosur nga konstruktori, deklaratën noteriale të konstruktorit mbi hartimin e projektit konstruktiv, si dhe llogaritjet analitike në CD; projekti hidrosanitar i firmosur nga inxhinieri hidroteknik (kanalizime, ventilim, ngrohje, mbrojtje nga zjarri), si dhe relacioni përkatës; projekti elektrik i firmosur nga inxhinieri elektrik, si dhe relacioni përkatës; projekti i ngrohje-ftohje-ventilim i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues; projekti i mbrojtjes nga zjarri i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues; projekti i plotë i sistemimeve të jashtme i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues;

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

projekti i plotë i lidhjes së objektit me rrjetin inxhinierik kryesorë i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues; preventivi i plotë i projektit, duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit i firmosur nga grupi preventivues i pajisur me licencën përkatëse; specifikimet teknike të firmosura nga inxhinierët përkatës; raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis; çertifikatën e përkohshme të performancës së energjisë.

Në nenin e njëzetë e shtatë është përcaktuar që për kryerjen e oponencës për projektet e infrastrukturës rrugore duhet të dorëzohen pranë institucionit që do të jetë përgjegjës për kryerjen e oponencës dokumentacioni teknik si kërkesa e zhvilluesit për kryerjen e oponencës; detyra e projektimit të plotë, e miratuar nga zhvilluesi (originale ose fotokopje e noterizuar); planimetria e zonës ku kalon gjurma e rrugës; studimi gjeologo-inxhinierik i zonës ku shtrihet trupi i rrugës; studimi topografik i zonës; studimi inxhinierik – sizmiologjik për rrugët që kanë vepra arti të mëdha; raporti hidrologjik e klimaterik i zonës si dhe llogaritjet hidraulike; llogaritjet analitike të veprave të artit të firmosura nga inxhinieri; raporti teknik ku të përfshihet dhe llogaritja e shtresave rrugore; projekti i zbatimit të rrugës (vizatimet) ku përfshihen planimetria, profili gjatësor, profilet tërthor, profilet tërthor tip, detajet; projekti i veprave të artit; projekti elektrik (ndriçimi rrugor) i sigluar nga inxhinieri elektrik, licenca e inxhinierit elektrik, si dhe relacioni përkatës; projekti i sinjalistikës rrugore, detaje sinjalistike, si dhe relacioni përkatës; preventivi i plotë duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve të projekteve, hartuar nga projektuesit i firmosur nga grupi preventivues; specifikimet teknike; licencat e grupit të projektimit dhe shoqërisë projektuese; raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në këtë nen është përcaktuar që ky dokumentacion të paraqitet në formë hardcopy dhe elektronike.

Në nenin e njëzetë e tetë është përcaktuar që për projektet e objekteve shtetërore që rikonstruktohen kërkesa për oponencë duhet të shoqërohet nga dokumentacioni teknik si kërkesa e zhvilluesit drejtuar institucioneve të përcaktuara; detyra e projektimit të miratuar nga zhvilluesi (originale ose e noterizuar); marrëveshja midis zhvilluesit dhe sipërmarrësit të hartimit të projektit; relacion teknik mbi gjëndjen ekzistuese të objektit shoqëruar me foto përkatëse; projekti arkitektonik ekzistues; projekt ideja e miratuar nga zhvilluesi; projekti konstruktiv ekzistues, llogaritjet konstruktive analitike për objektin ekzistues; licenca e inxhinierit konstruktor (e noterizuar); deklaratë noteriale e konstruktorit mbi hartimin e projektit konstruktiv, llogaritjet analitike në formë elektronike; studimi gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit i rifreskuar (noterizuar); studimi inxhinierik-sizmiologjik (noterizuar) për objekte mbi tetë kate ose vërtetim nga Instituti i Gjeoshkencës për objekte nën tetë kate; projekti hidroshpërndarës i firmosur nga inxhinieri hidroteknik (kanalizime, ventilim, ngrohje mbrojtje nga zjarri), licenca e inxhinierit hidroteknik (noterizuar), si dhe relacioni përkatës; projekti elektrik i firmosur nga inxhinieri elektrik, licenca e inxhinierit elektrik (noterizuar), si dhe relacioni përkatës; preventivi i objektit i firmosur nga grupi preventivues dhe zhvilluesi të pajisur me licencë përkatëse; çertifikatën e përkohshme të performancës së energjisë; licenca e zhvilluesit dhe projektuesit apo grupit të projektimit; specifikime teknike.

Për rastin kur mungon projekti konstruktiv ekzistues është përcaktuar që kërkesa të shoqërohet me aktekspertizën e gjëndjes ekzistuese të objektit, i cili hartohet nga një grup

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".

specialistesh të liçensuar sipas fushave përkatëse, të miratuar nga zhvilluesi, shoqëruar dhe me fotot e gjendjes ekzistuese në pjesën e jashtme të objektit (fasadë) dhe pjesën e brendëshme të tij.

Në nenin e njëzetë e nëntë është përcaktuar që kur personi fizik apo juridik i hartimit të projektit është shtetas i huaj duhet të dorëzojë dokumentacionin përkatës në gjuhën shqipe; marrëveshja midis zhvilluesit të projektit dhe shoqërisë vendase, e cila ka kryer përkthimin e projektit (fotokopje e noterizuar); Liçencat e grupit të projektimit, kur janë projektues të huaj dhe e drejta e ushtrimit të profesionit i njihet në vendin e origjinës, të konvertuara sipas legjislacionit në fuqi për liçencimin.

Në kreun IV përcaktohen dispozitat përfundimtare i cili përbëhet nga 3 nene.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Instituti i Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe çdo autoritet i planifikimit që miraton lejet e ndërtimit.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Përsa u përket shpenzimeve buxhetore në projektakt nuk parashikohet që të ketë të tilla.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR**

Belinda Balluku

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit".